



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:065076
Datë: 30.01.2019
Numri i dokumentit: 00215562

P.nr.1394/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni

Penal, si gjykatë e shkallës së parë penale, e përbërë nga gjyqtarja individuale Fitore Daci, me Zyrtarin ligjor Burim Haxhidema, në çështjen penale kundër të pandehurit K.R nga fshati...Komuna Shtime, për shkak të veprave penale vjedhje pylli nga neni 358, par.2,të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1909-5/18, të dt.25.10.2018, vjedhje pylli nga neni 358, par.1,të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1920-6/18, të dt.26.11.2018 si dhe vjedhje pylli nga neni 358, par.2,të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.2067-1/18, të dt.16.10.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, me datën 14.01.2019, në praninë e përfaqësuesit të akuzës, prokurorit të shtetit Ismet Rrahmani dhe të pandehurit, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: K.R, i lindur më datë....., me vendbanim në Fshatin Komuna Shtime, nga babai dhe e ëma e gjinisë ..., ka të kryer shkollën e mesme, i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike, i martuar, baba i një fëmije, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse :

1.Me datën 26.04.2018, rreth orës 01:10 min në mesnatë, në pyllin publik, në vendin e quajtur “ Përroi i Thatë ”, në rajonin Ekonomiko-pyJORë Petrovë, Komuna Shtime, në paralelen 11/00, është takuar duke prerë 61 copë trungje të llojit të ndryshëm, me diametër prej 16-27 cm, e të gjata 9-11, e me vëllim të përgjithshëm prej 5.62 metër kub, në vlerë prej 859.86 €, drunj të kanë qenë të prerë me sharrë motorike dhe të transportuara me traktor.

2.Me dt.28.korrik 2018, rreth orës 13:30, në vendin e quajtur “ Përroi i Thatë ”, në rajonin Ekonomiko-pyJORë Petrovë, Komuna Shtime, me qëllim vjedhje, në pyllin e pronësisë shoqërore, me sharrë motorike ka prerë tetëdhjetë e një (81) trungje druri të llojit ah, me diametër 7-25 cm, me gjatësi prej 9-11 metër, me vëllim të përgjithshëm prej 3.23 metër kub, duke i shkaktuar kështu dëm Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik, Sektorit për Bujqësi , Pylltari dhe Zhvillim Rural në Komunën e Shtimes, në vlerë prej 494,19 €.

3.Me dt. 22.09.2018, rreth orës 00:20, në vendin e quajtur “ Kodra Sadikut ”, në rajonin Ekonomiko-pyJORë Devetak, Komuna Shtime, me të cilën qeverisë Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari Komuna Shtime, me qëllim vjedhje, me sharrë motorike ka prerë pesëdhjetë e pesë (55) trungje dru të llojit qershi, bung, ah, me diametër 17-22 cm, me gjatësi prej 11 metër, me vëllim të përgjithshëm prej 5.52 metër kub, duke i shkaktuar kështu dëm material prej 742,99 €.

- me të cilën ka kryer veprën penale vjedhje pylli në vazhdim nga neni 358 par. 2, lidhur me nenin 81 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 4,7,17,21,41,42,48,49,50,51,52,60, 73, nenit 358 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 365, 453 të KPPRK-së, të pandehurin e:

G J Y K O N

ME DËNIM ME GJOBË në lartësi prej 300 € (njëqind euro), i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afat prej 1 viti (koha e verifikimit) nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

DHE ME DËNIM BURGIMI NË KOHËZGJATJE PREJ 3 (TRE) MUAJ, ku në mbështetje të nenit 48 par.1 të KPPRK-së, dënimi i shqiptuar me burgim me pëlqimin e të pandehurit i zëvendësohet ME PUNË NË DOBI TË PËRGJITHSHME PREJ 140 (njëqind e dyzet) ORËVE të cilin dënim do ta kryej në afat prej 3 muaj, prej ditës së fillimit të ekzekutimit.

Konform nenit 48 par. 2 të KPK-së, Shërbimi Sprovues Republikës së Kosovës cakton llojin e punës që duhet të kryej personi i dënuar, cakton organizatën në të cilën duhet të punoj i dënuari, cakton ditën, javën që i dënuari duhet të kryej punë në dobi të përgjithshme, si dhe të mbikëqyrë e punën në dobi të përgjithshme.

Konform nenit 48 par.4 të KPRK-së, nëse personi i dënuar nuk e kryen punën në dobi të përgjithshme ose e ka kryer vetëm pjesërisht, gjykata do të urdhëroj zbatimin e dënimit të shqiptuar sipas këtij aktgjykimi në përpjesëtim me punën e kryer.

Obligohet i pandehuri që palës së dëmtuar Drejtorisë për Bujqësi dhe Pylltari-Komuna Shtime , të ia paguaj dëmin në shumën prej 2097,04€(dymijë e nëntëdhjetë e shtatë euro e katër cent).

Obligohet i pandehuri që të paguaj paushallin gjyqësor shumën prej 20 €, si dhe shumën prej 30€ në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, në afat prej 30 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj sipas aktakuzave të evidentuar si PP/II.nr.1909-5/18, të dt.25.10.2018, PP/II.nr.1920-6/18, të dt.26.11.2018 si dhe PP/II.nr.2067-1/18, të dt.16.10.2018, ka akuzuar të pandehurin K.R për veprat penale Vjedhje pylli nga neni 358 par.1 dhe par.2 të KPRK-së, duke propozuar që i pandehuri të shpallet fajtor dhe ti shqiptohet sanksion penal i paraparë me ligj.

Gjykata duke pasur parasysh parimin e ekonomizimit dhe të efikasitetit të procedurës penale, me pajtimin e palëve respektivisht të pandehurit dhe prokurorit të shtetit si dhe duke marrë për bazë faktin se i pandehuri ka hjekur dorë nga kundërshtimi i aktakuzës për veprën penale vjedhje pylli, sipas aktakuzës PP/II Nr.1909-5/18 të dt. 25.10.2018, e po ashtu duke vepruar konform nenit 35 par. 1 dhe 8 të KPPRK-së, në shqyrtim fillestar mori aktvendim që të bashkohet procedura penale dhe të zbatohet procedurë unike kundër të pandehurit K.R për lëndët: PP/II.nr.1909-5/18, të dt.25.10.2018, PP/II.nr.1920-6/18, të dt.26.11.2018 si dhe PP/II.nr.2067-1/18, të dt.16.10.2018, ashtu që çështja penale për këto tri lëndë do të udhëhiqet me numrin më të vjetër P.nr.1337/18.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 14.01.2019 në të cilën shqyrtim: i pandehuri e pranon fajësinë për veprën penale të cilën e ngarkon aktakuza për të gjitha pikat e saj, dhe është i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë dhe pasojat që mund të vijnë nga ky pranim, i vjen keq për këtë vepër penale, është mbajtës i familjes-kryefamiljar, baba i një fëmije, si dhe drutë i ka marrë për djegie për shkak të kushteve të rënda ekonomike, i premton gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsëris, andaj në bazë të gjithë këtyre të gjeturave i propozon gjykatës që ti ketë parasysh dhe të më shqiptoj një dënim më të butë.

Prokurori i Shtetit Ismet Rrahmani duke shprehur mendimin e tij përkitazi me pranimin e fajësisë, ka vlerësuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit konform nenit 248 të KPPK-së, andaj meqenëse plotësohen kushtet ligjore nga neni 81 par. 1 pika 1.1, 1.2, 1.3,1.4 dhe 1.5 të KPRK-së, bënë rikualifikimin juridik të veprës penale edhe atë në vend të tri veprave penale vjedhje pylli në një vepër penale në vazhdim vjedhje pylli nga neni 358 par. 2 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, duke i propozuar Gjykatës që të pandehurin ta shpall fajtor dhe të i shqipton dënim sipas ligjit.

Me që i pandehuri ka pranuar fajësinë gjyqtarja e vetme gjykuese ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 248 par.1 të KPPK-së: i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe ne provat tjera te cilat gjinden ne shkresën e lendes siç janë fletëparaqitja e rojës së pyllit dhe llogaritja e dëmit të pyllit me numër 64/2018 e dt.17.09.2018 e DBPZHR-së në Ferizaj, fletëparaqitja e rojës së pyllit me numër të ditarit 49/2018 me numër të

protokollit 112/2018 edt. 12.gusht 208, procesverbali i komisionit të ekspertëve me numër protokollit 112/2018 e dt. 17 shtator 2018, Fletëparaqitja e rojës së pyllit me nr,81/18 e dt.22.09.2018, procesverbali i përpiluar nga komisioni i ekspertëve të pylltarisë për vlerësimin e dëmit të shkaktuar.

Me qenë se i pandehuri ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj gjyqtarja individuale konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit, *(nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Gjykata pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat e tjera në bazë të vlerësimit të tillë vërtetoi gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale në vazhdim vjedhje pylli nga neni 358 par.2 të KPRK-së për faktin se objekti i njëjtë veprës penale, shfrytëzimi i situatës së njëjte apo marrëdhënies së njëjtë kohore, vendi apo hapësira e njëjtë e kryesit të veprës penale si dhe dashja e njëjtë e kryesit të veprës penale.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë lehtësuese se në shqyrtimin fillestar ka pranuar fajësinë, duke e shprehur pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, nuk është vërtetuar se ka qenë i dënuar me ndonjë aktgjykim të formës së prerë, e që këto rrethana i ndërliidhi me rrethanat personale, i papunë, i gjendjes së vështirë ekonomike, kryefamiljarë, baba i një fëmije, ndërsa në mungesë të rrethanave veçanërisht rënduese, gjykata vlerësoi shkallen e përgjegjësisë penale të të pandehurit dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave, të pandehurit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënimit të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejtë në

raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallen e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurit.

Obligohet i pandehuri që të ia kompensoj dëmin DBP-Shtime , në shumën e përgjithshme prej 2097,04€(dymijë e nëntëdhjetë e shtatë euro e katër cent), në afat prej 30 ditëve nga dita kur aktgjykimi te merr formën e prere, nën kërcënimin e përmbarimit.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 20€ si dhe shumën prej 30€ në emër të fondit për kompensimin e Viktimave të Krimit, në afatin prej 30 ditëve pasi që aktgjykimi të marr formën e prerë nën kërcënimin e përmbarimit.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P.nr.1394/18 datë 14.01.2019.

Zyrtari ligjor

Burim Haxhidema

Gjyqtarja

Fitore Daci

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.